

Z. Kozma Kondakçiu është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike Elektrike degën Metalurgji. Që prej vitit 1997 është pjesë e stafit të SH.K.SH (KLSH) në pozicionin e Inspektorit të parë në SH.K.SH Qendër.

Ai ka një eksperiencë prej 25 vitesh në KLSH duke punuar ndër të tjera në detyra drejtuese si: Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Prokurimeve Publike dhe Investimeve të Huaja në vitet 1999-2000, Përgjegjës Sektori i Zhvillimit Kompjuterik në KLSH në Kabinetin e Kryetarit në vitet 2000-2002, Drejtor i Drejtorisë Organizimit dhe Informacionit në vitet 2002-2005, Kryespecialist për teknologjinë e informacionit në vitet 2005-2006, Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit 2014- 2018, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit 2018- 2022.

Aktualisht është Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, 2022 e në vazhdim.

Gjatë 25 viteve në KLSH është specializuar e certifikuar në fusha të ndryshme të auditimit dhe teknologjisë së informacionit nga organizata kombëtare e ndërkombëtare ku veçojmë certifikimin si Auditues IT nga IDI (Inisiativa për zhvillim i INTOSA-it) në vitin 2014. Ne analizimin e të dhënave të "Big Data" me programet IDEA , Tableau etj. Është autor i disa botimeve në medianë e shkruar e konferenca shkencore mbi auditimin e Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimit të bazave të të dhënave në auditim.